

VENDIM
Nr. 203, datë 13.3.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS NË LAGJEN “1
MAJI”, NË BASHKINË E ORIKUMIT TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës në lagjen “1 Maji”, në bashkinë e Orikut të qarkut të Vlorës.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Orikut.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në masën përkatëse, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 32.5 (tridhjetë e dy pikë pesë) m², truall, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 580 677.5 (pesëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i bashkisë së Orikut, sipas planifikimeve përkatëse.
 5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Orikut.
 7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Orikut për realizimin e këtij projekti.
 8. Regjistrimi i ri i pasurisë 32.5 (tridhjetë e dy pikë pesë) m², truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Orikut, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Orikut për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha